



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 21 qershor 2016, në mbledhjen e tretë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Sami Ajeti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Nivel komunal; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim; z. Bunjamin Hoti, përfaqësues i OJQ-ve; z. Fadil Halimi, përfaqësues i Mediave lokale; z. Avni Shabani, përfaqësues i Komunitetit të biznesit dhe z. Idriz Hoxha, përfaqësues i komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame dhe z. Sabedin Rama, përfaqësues i Komunitetit rom.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: përfaqësuesi i KFOR-it dhe përfaqësuesit e OSBE-së- znj. Laia Pau Romani dhe Skender Shatri.

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës**, Mirë se keni ardhur, më lejoni të hapi mbledhjen e III(tretë) të KKSB-së, për këtë vit. Rendin e ditës me materialet përcjellëse besoj se i keni marrë me kohë. Nëse jeni dakord mund të fillojmë me punë.

### **1. Rend i propozuar i ditës**

U miratua njëzëri.

### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 19.04.2016**

U miratua njëzëri

### **3. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë**

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës**, fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bekim Bislimi.

**z. Bekim Bislimi**, ju informoj se gjendja e sigurisë në komunë është e qetë dhe nuk pritet që në të ardhmen të ketë eskalim në raport me sigurinë e përgjithshme. Ne kemi bërë një analizë të situatës në përgjithësi dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi 43 raste më shumë të raportuara, nga 440 sa ishin në vitin 2015, 483 në 2016, aksidente 88 në 2015 ndërsa 85 në 2016 me dëme materiale, numri i vjedhjeve 68 në 2015, ndërsa 85 në vitin 2016.

Me aprovimin e “Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020”, Policia e Kosovës ishte ndër akterët relevant në këtë proces. Jemi përkushtuar në implementimin e obligimeve që rrjedhin nga kjo Strategji në bashkëpunim me akterët

tjerë të rëndësishëm përmes planit të veprimit, andaj kërkoj nga të gjithë akterët relevant të bashkëpunojnë ngushtë me organet e rendit me qëllim të realizimit të saj.

Në këtë çështje komuna e Podujevës është në nivel të kënaqshëm, megjithatë duhet të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim. Për gjendjen e tillë në këtë aspekt falënderoj të gjithë akterët, veçanërisht BIK-un në Podujevë.

Jemi në prag të sezonit të verës ku pritet organizimi i ahengjeve të ndryshme, dasmave dhe manifestimeve publike dhe si rezultat i kësaj në vitin e kaluar kemi pasur fatkeqësisht edhe lëndime të qytetarëve nga të shtënat me armë. Gjatë vitit të kaluar kemi mbajtur takime me qytetarë, pronarë të objekteve hoteliere, KLSP, përfaqësues të BIK-ut dhe subjekte tjera me qëllim të sensibilizimit të popullatës për rreziqet që paraqet kjo dukuri. Këtë vit do të vazhdojmë me takime të ngjashme. Nga 1 qershori është në implementim projekti "Festo me zemër e jo me armë". U bëj apel të gjithëve që të shfrytëzojnë ndikimin e tyre me qëllim të transmetimit të rrezikut që paraqesin të shtënat me armë, kjo përveç se paraqet rrezik për qytetarë është edhe e sanksionuar me ligj. Këtë vit veç se kemi një të lënduar nga të shtënat andaj ju transmetoj se toleranca e organe të rendit do të jetë zero në këtë drejtim.

Në këtë periudhë kohore kemi konfiskuar armë dhe municione të kalibrave të ndryshme, gjithsejtë 28 armë dhe 256 municione, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë konfiskuar 20 armë. Fatkeqësisht këtë muaj si rezultat i një konflikti mes palëve në një fshat të Podujevës ka rezultuar me viktima. Ne kemi rifreskuar listën e familjeve të cilat kanë pasur dhe kanë mosmarrëveshje dhe në ditët në vijim pres të mbajmë një takim me përfaqësues të BIK-ut në mënyrë që Bashkësia Islame të shfrytëzoj autoritetin dhe ndikimin e saj (ku dihet se angazhimi dhe sukcesi i tyre s'ka munguar deri më tani), në pajtimin e këtyre familjeve, gjithashtu edhe angazhimin e OJQ-ve, mediave lokale të informimit si dhe të gjithë qytetarët e vullnetit të mirë, në mënyrë që të veprohet konkret në këtë drejtim. Me Drejtorinë e Inspeksionit kemi ngritë çështjen e operimit (pa licencë) të barkave dhe motoskafeve të cilët janë prezentë në Liqenin e Batllavës, si dhe parandalimin e operimit të taksive ilegal, konsideroj se janë arritur rezultate në këtë drejtim me ndëshkimet kundërvajtëse dhe konfiskimit të veturave. Gjithashtu kemi rezultate edhe në identifikimin e hapësirës për kultivimin e bimëve narkotike, dhe nga Njësia relevante është asgjësuar kjo sasi.

Vlen të theksohet se në rastin e dëmtimit të shkollës në fshatin Dobërdol është bërë identifikimi i kryerësve të aktit dhe pritët të zhvillohen edhe veprimet tjera procedurale, ngritja e kallëzimit penal ndaj tyre. Duke ju falënderuar bashkëpunimit me qytetarë në një rast kemi arritur të arrestojnë një person të dyshuar për vepër penale.

Në interes të ngritjes së sigurisë së përgjithshme, fillimisht si ide, ofroj "Projektin e vendosjes së kamerave" brenda në qytet duke përfshirë rrugët kryesore, pastaj hyrje daljet në qytet me qëllim të parandalimit si dhe ndalimin dhe ndëshkimin e kryerësve të veprave kriminale. Në këtë aspekt jemi konsultuar me bazën ligjore, e cila ekziston dhe pres përkrahje nga ana e juaj. Sfidë për realizimin e këtij projekti shohim anën financiare, megjithatë shpresoj në përkrahjen nga Kryetari i Komunës.

E përsëris kemi mangësi sa i përket burimeve njerëzore, përkundrazi jemi duke u sfiduar edhe më me transferimin e zyrtarëve policor. Po ashtu kemi mungesë edhe të burimeve teknike dhe pajisjeve teknologjike si dhe nevojë për furnizim me vetura zyrtare-civile për kryerjen e punëve operacionale. Përkundër të gjitha këtyre vështirësive, bazuar në angazhimet dhe bashkëpunimin me institucionet e komunës rezultatet nuk mungojnë.

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** fjalën e ka përfaqësuesi i KFOR-it, nëse ka diçka rreth gjendjes së sigurisë.

**Përfaqësuesi i KFOR-it,** faleminderit, s'ka diçka të raportohet nga ana e KFOR-it, vetëm dua të falënderoj të gjitha institucionet komunale për bashkëpunimin e mirë.

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** unë e hap diskutimin në lidhje me raportin e Komandantit të Stacionit të Policisë, nëse keni diçka. Sigurisht gjatë raportimit e vërejtët që rezultoi edhe një kërkesë për tu diskutuar, çështja e instalimit të kamerave në qytet, por edhe vështirësitë e zakonshme që komandanti i ka paraqitur më herët, sa i takon edhe burimeve njerëzore dhe mungesës së pajisjeve teknike dhe teknologjike, këto janë për ne të njohura, ndërsa si çështje e re e pa diskutuar më parë u shtrua vendosja e kamerave në rrugët kryesore të qytetit. Është mirë që nga ky takim të bëjmë një vlerësim, pastaj të shohim edhe mundësitë tjera që i përmendi komandanti.

**z. Shaban Ahmeti**, theksoi, para 4-5 dite në rrugën ‘‘Ali Ajeti’’, ndodhi një rast ku një veturë e goditi një fëmijë, por për fat të mirë fëmiju shpëtoi, i cili është i familjes time. Problemi qëndron se në atë rrugë është duke u vozitur shumë shpejt.

**z. Radisav Peroviq**, theksoi një shqetësim që kishte pasur dje në pike kalimin kufitar në fshatin Metergoc, me Policinë kufitare. Nënvizoi, afër shtëpisë time më ndaloj Policia kufitare rreth 30 min. me arsyetimin se nuk mund të kaloj kufirin, sepse kjo nuk lejohet. Policia kërkoi që për kalimin e kufirit duhet ta kem të lejuar me shkrim. U kam thënë se për këtë janë të njoftuar organet e rendit. Kërkoj mundësisht që të më bëhet zgjidhje dhe të na mundësohet neve si komunitet kalimi i kufirit pa problem, unë nuk e di se çfarë të bëjë ndërsa kam familjen në Medvegjë dhe unë duhet të shkoj t’i vizitoj dhe të më vizitojnë. Përndryshe jam i kënaqur me Policinë e Stacionit dhe në kohëzgjatje më të madhe edhe me Policinë kufitare, megjithatë herë pas herë më kanë shkaktuar shqetësime.

**z. Faik Muçiqi**, komandanti përmendi si çështje shqetësuese mungesën e stafit edhe pse janë paraqitur disa herë kërkesa për ngritjen e numrit të zyrtarëve policor. Ky shqetësim prap po vazhdon, nuk ka ngritje të numrit të zyrtarëve.

**z. Bunjamin Hoti**, nga raporti i paraqitur vërejtja se ka një ngritje të lehtë të numrit të rasteve të vjedhjeve, krahasuar nga viti 2015 me vitin 2016. Inkurajoj Policinë që të merret më tepër me këto raste dhe të parandaloj aq sa ka mundësi dhe çdo herë në bashkëpunim me qytetarët, ndërsa sa i përket çështjes për vendosjen e kamerave në qytet, ne po shohim se në komunën e Podujevës, sidomos gjatë sezonit të verës shtohet numri i banorëve që vijnë nga jashtë dhe ka një frekuentim më të madh dhe vendosja e kamerave në këto rrugë, në qoftë se do të kishte mundësi buxhetore do të ishte një përparësi e madhe në aspektin e ruajtjes së sigurisë dhe të ndihmës së madhe në punën e Policisë në të ardhmen. Mendoj se është ide e mirë, ndërsa do e shtroja një pyetje për Komandantin lidhur me një incident që ndodhi para dy dite te Xhamia e vjetër në qytet, pas thyerjes së veturave a është nxjerrë ndonjë raport se rasti a ka qenë me ndonjë tendencë të veçantë apo veprimi është bërë nga ndonjë huligan.

**z. Fadil Halimi**, nga raporti i Policisë i paraqitur nga Komandanti më duket interesante çështja për vendosje të kamerave në rrugët kryesore të qytetit. Projekti nuk e di se sa është i kushtueshëm, por mendoj se vendosja e kamerave cenon lirinë dhe integritetin e qytetarëve, pra qytetarët do të jenë nën vëzhgim. Nuk jam në dijeni se vendosja e kamerave a mund të ndikojë në sigurinë e qytetarëve, nuk kam dëgjuar për projekte të tilla dhe nuk e di se kjo ide a është e menduar mirë. Për sigurinë e qytetarëve duhet të kujdesemi ne, janë organet kompetente, pastaj për çështje të sigurisë nuk e di pse duhet të konsultohet edhe Bashkësia Islame, shumë rol është duke iu dhënë në pajtimin e qytetarëve dhe në qështje të sigurisë kur tani kemi organet e rendit .

**z. Bekim Bislimi**, fillimisht po ndalem te komunikacioni që u potencua për vozitje të shpejtë të automjeteve në mjediset ku banohet. Nuk mund të them se nuk ka vozitje të shpejtë. Nuk e kam në parim të ankohem për mungesë të burimeve njerëzore por është evidente që nuk kemi burime njerzore. Momentalisht kemi 16 zyrtarë mungesë me strukture, duke përjashtuar edhe pjesën tjetër që janë në pushime mjeksore që aktualisht janë 4, dmth. Jemi me 71 zyrtar duke mbuluar komplet rajonin e komunës së Podujevës, duke përfshirë Stacionin Policor dhe nënstacionin e Orllanit. Përkundër kësaj këtë muaj është angazhim i të gjithë zyrtarëve policor pikërisht në vendosjen e pikave të kontrollit dhe shqiptimit të kundërvajtjeve. Ka ditë që shqiptohen deri në 40 kundërvajtje, nuk ka ditë që në atë pjesë të rrugës Ali Ajeti ku është aksidentuar fëmiju nga vetura, të vendosen të paktën 1 apo dy pika kontrolli. Në këtë kohë kemi qenë të përqendruar më tepër në pjesët periferike e jo në brendi të qytetit, me qëllim ti minimizojmë aksidentet dhe është arritur rezultat në raport me vitin e kaluar. Ndihet shumë mungesa e 20 zyrtarëve policor. Atë që potencoi drejtori i Shërbimeve Publike, kemi mungesë përveç burimeve njerzore edhe të burimeve tjera që neve na vështirësojnë dukshëm punën. U potencua edhe incidenti i mëhershëm, i ditës së shtunë rreth orës 11:15, Policia është njoftuar për një tentim thyerjeje të 4 veturave te Xhamia e qytetit, ne jemi duke u marrë me rastin, është herët dhe nuk mund të prejudikohen motivet, por në bazë të hetimeve të prokurorit kjo është cilësuar si vjedhje e rendë e nuk ka të bëjë me ndonjë motiv tjetër. Sa i përket projektit të vendosjes së kamerave, unë konsideroj se vendosja e kamerave e ngritë nivelin e sigurisë së përgjithshme, nuk e cenon lirinë dhe të drejtat e njeriut dhe vendosja e kamerave mundësohet edhe me ligj. Ky projekt veç është në implementim e sipër në komunat tjera dhe praktika ka dëshmuar se ka pas rënie të aktiviteteve kriminale por edhe zbulim të kryesve të veprave penale. Ne kemi raste, nuk po flas për

vjedhjet e rënda por kur bëhet një aksident dhe vozitësi ik, ndoshta shkon një periudhë e gjatë për ta identifikuar dhe konsideroj se pikërisht kjo do të na shërbente, në veqanti organeve të rendit por do të kishte edhe ndikim pozitiv te qytetarët.

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** e përshëndesim punën e Policisë për faktin se numri i veprave penale është në rënie dhe në zbulimin e rasteve të ndryshme kriminale, kapjen e kryerësve kriminal dhe nxjerrjen e tyre para organeve të drejtësisë. Më gëzoi fakti që rasti i vandalizmit në shkollën e fshatit Dobërdol është zbuluar dhe është në prag hapja e procedurave në mënyrë që kryerësit e kësaj veprë të shëmtuar të nxjerrën para organeve të drejtësisë. Sa i takon kërkesës për vendosje të kamerave, prita nga ju se do të jepni ndonjë mendim, përveç z. Fadil Halimit nuk dëgjova diçka tjetër, është mirë që ne si Këshill ta diskutojmë këtë çështje më seriozisht, në mënyrë që të kemi një qëndrim lidhur me këtë nismë, duke i pasur parasysh edhe dispozitat ligjore që e rregullojnë edhe fushën e sigurisë dhe të ruajtjes së privatësisë. Duhet theksuar se në shumë lokale dhe objekte këto veçse janë instaluar. Nëse jeni dakord këtë mund ta shtrojmë si çështje apo pikë të veçantë të rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme, në mënyrë që të japim një mendim. Sa i përket shqetësimit të z. Radosav Peroviq, ky shqetësim ka një kohë që është bërë prezentë në këto takime dhe në biseda me mua dhe ka qenë vullnet i yni që ta diskutojmë këtë çështje, ta përcjellim edhe në organet dhe instancat më të larta, nga se ne nuk jemi kompetentë për të zgjidhur këtë problem, kalimin e kufirit, kjo është e rregulluar me dispozita ligjore. Ne vazhdimisht kemi pas një mirëkuptim për z. Peroviq dhe familjen e tij që në rastet e takimeve familjare të ju lehtësohet ai kalim kufitar, që mos të bëjnë kilometra të tërë për të dalë në pikën kufitare. Unë dhe Komandanti do të angazhohemi, të bisedojmë me përgjegjësit e Policisë Kufitare me qëllim të rregullimit të kësaj çështjeje. Unë e falënderoj Komandantin për raportin dhe KFOR-in si dhe për bashkëpunimin dhe besoj se ky bashkëpunim i mirë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Kalojmë në pikën e radhës.

#### **4. Sensibilizimi dhe inicimi i aktiviteteve për parandalimin e qitjes me armë në dasma, ahengje dhe manifestime publike**

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** fjalën e ka Komandanti i Policisë.

**z. Bekim Bislimi,** unë këtë veçse e potencova në kuadër të raportit të paraqitur. Vitin e kaluar kemi mbajtur takime me të gjithë ata që kemi menduar se mund të kontribuojnë dhe ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim. Në zbatim të Planit operativ që ka qenë dhe është funksional, ka pas raste të gjuajtjes me armë dhe fatkeqësisht edhe dy qytetarë janë lënduar gjatë ahengjeve dhe dasmave. Realisht në këtë periudhë kohore për shkak të muajit të Ramazanit nuk kemi shumë ahengje, ndërsa raste të gjuajtjeve me armë ka pas, me ç'rast janë konfiskuar armët dhe janë ngritë kallëzime penale. Unë apeloj që të gjithë që kanë mundësi të kontribuojnë në këtë drejtim të shtrijnë autoritetin në mënyrë që mos të përdoren armët, kjo është edhe e sanksionuar me ligj. Pritet që pas muajit të Ramazanit do të ketë ahengje bukur shumë, ne planifikojmë prap takime. Shumica e ahengjeve dhe dasmave po mbahen nëpër objekte hoteliere, gjë që ka treguar se ka qenë një numër shumë i vogël i gjuajtjeve me armë. Falënderoj bashkëpunimin e pronarëve të objekteve hoteliere, të cilët e kanë përcjellë mesazhin e Policisë se ndalohet gjuajtja me armë. Në takimet që do të kemi do ta përçojmë të njëjtin mesazh. z. Fadil Halimi theksoi se nuk është në dijeni se çfarë roli ka këtu Bashkësia Islame, unë konsideroj se çdo herë kur është në pyetje interesi i përgjithshëm duhet dhënë hapësirë të gjithë mekanizmave.

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** sa i përket rolit të Bashkësisë Islame në pajtimin e ngatërresave mes qytetarëve, pasi kjo më tepër është shprehur si shqetësim, brengë, ngase një numër i familjeve janë në ngatërresa, atëherë meqë janë mundësitë potenciale të gjithë mekanizmat që kanë përgjegjësi dhe rol në këtë aspekt, të merren me këtë çështje, në mënyrë që ato probleme të zgjidhën. Ne kryesisht duhet të bazohemi në mekanizmat që janë paraparë me ligj, mundësohen edhe format e ndërmjetësimit, por gjithsesi zbatim duhet të gjej forma ligjore, por kontributi edhe i të tjerëve për ofrim të qytetarëve nuk është i tepërt dhe është mirë secili që ka mundësi të kontribuoj në këtë çështje. Për sa i takon sensibilizimit dhe inicimit të aktiviteteve për parandalim e hapi këtë çështje nëse keni diçka për të shtuar dhe për të parë se a kemi nevojë ne si Këshill për të ndërmarrë ndonjë veprim apo aktivitet.

Nëse nuk keni diçka rreth kësaj teme, kalojmë në pikën e radhës.

## **5. Njoftim me Strategjinë e Zyrës së Kryeministrit – Zyra për Planifikim Strategjik për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015-2020 -Hartimi i Planit të veprimit komunal për implementimin e Strategjisë**

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** fjalën e ka z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

**z. Nexhmi Rudari,** siç shihet Strategjia është paraparë për periudhën 2015-2020. Për implementimin e kësaj duhet hartuar një plan të veprimit komunal. Strategjia është dokument kornizë që i përcakton parimet esenciale por në kuadër të komunës duhet të hartohet një plan i implementimit me përmbajtje të aktiviteteve të caktuara, bartësit e aktiviteteve, afate kohore për zbatim, si dhe me kosto nëse ka kosto të implementimit.

**z. Faik Muçiqi,** theksoi në funksion të implementimit të kësaj Strategjie kemi pasur një takim të përbashkët i kryesuar nga nënkryetari i i Komunës dhe disa anëtarë të KKSB-së me përfaqësues të Zyrës për Planifikim Strategjik, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Strategjia është dokument që nuk kemi nevojë ta diskutojmë. Drejtoria e Arsimit, Policia, në disa pika Këshillat rinore kanë për detyrë të hartojnë Planin e veprimit komunal për implementimin e Strategjisë. Sa i përket aspektit të implementimit duhet të raportojmë se deri ku jemi me implementim të Strategjisë

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** qëllimi është njoftimi me Strategjinë e Zyrës së Kryeministrit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015-2020. Në bazë të asaj që u diskutua rezulton që në hartim të këtij Plani të jetë një rreth i personave që merren më tepër me këtë çështje.

**z. Avni Maloku,** sipas dokumentit, pjesa më e madhe e aktiviteteve që duhet zhvilluar i takon fushës së Arsimit, mirëpo mendoj se duhet të definojmë që ta formojmë një komision apo ekip të përbashkët për hartimin e Planit apo grupe të veçanta ku secili nga fusha e vet të përgatitë aktivitetet e pastaj, një grup të përbashkët të merret me inkorporimin dhe harmonizimin e tyre. Si Drejtori e Arsimit i kemi identifikuar veprimet që duhet t'i ndërmarim.

**z. Bunjamin Hoti,** nëse është paraparë nga ana e hartuesve të kësaj Strategjie apo këtij plani që të ketë aktivitete vetëdijësuese, apo promovim të formave të ndryshme edhe të organizatave joqeveritare ju ofrojmë mbështetje këto dy institucionet kryesore rinore Këshilli i Veprimit Rinor Lokal dhe Qendra Rinore e Komunës së Podujevës për implementimin e kësaj Strategjie kundër të shtënave me armë.

**z. Faik Muçiqi,** propozoi që për hartimin e Planit të ngritët një grup i përbashkët.

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** në bazë të diskutimeve rezulton që për hartimin e Planit të jetë një grup që janë më në rrjedha të kësaj çështjeje, të jetë një grup i përbashkët.

Pas debatit dhe votimit u ngrit grupi punues për hartimin e Planit të veprimit komunal për implementimin e Strategjisë, në përbërje:

|                     |                                                               |          |
|---------------------|---------------------------------------------------------------|----------|
| 1. Avni Maloku,     | drejtore i Drejtorisë së Arsimit,                             | kryesues |
| 2. Bekim Bislimi,   | komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë,                | anëtar   |
| 3. Sami Ajeti,      | kryetar i Këshillit të Prindërve në nivel komunal             | anëtar   |
| 4. Bekim Jashari,   | kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame- Podujevë,           | anëtar   |
| 5. Radisav Peroviq, | përfaqësues i komunitetit serb,                               | anëtar   |
| 6. Agron Hyseni ,   | drejtore i drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, | anëtar   |
| 7. Bunjamin Hoti,   | përfaqësues i OJQ-ve,                                         | anëtar   |

## **6. Të ndryshme**

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** i njoftoi të pranishmit se z. Sabedin Rama, anëtar i Këshillit ,përfaqësues i komunitetit rom ka ofruar dorëheqje të përvokueshme nga cilësia e anëtarit të KKSB-së.

### *Konstatim*

Këshilli njëzëri aprovoi dorëheqjen e z. Sabedin Rama.

Shërbimi përkatës i administratës të ndërmerr të veprimet ligjore n ‘funksion të plotësimit të Këshillit me një anëtar të ri nga komuniteti rom.

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës,** do ti bëjmë një thirrje komunitetit rom që të nominojë një përfaqësues të tyre dhe çështja do t'i procedohet Kuvendit të Komunës për miratim.

Kryetari përfundoi mbledhjen pasi që nuk pat çështje tjera për shqyrtim, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

**Mbledhja përfundoi në orën 11.15**

**Procesverbalin e mbajti**

**Sabedin Namani**

**Nr. 02-006-53770**

**Podujevë,**

**21 qershor 2016**

**Kryetari i Komunës**

**Agim Veliu**